



Pranuar / Dorezuar Prilaps/Prilato Received/Delivery		16.06	2023	3	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	4819/2023			113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.825/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: nga Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.825/2023 të datës 08.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë rr. _____ Komuna e Fushë Kosovës kundër heshtjes administrative të Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "Vlerësim i Rezultateve në Punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.825/2023 i datës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____ punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, me datë 08.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4631/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komunës së Fushë Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr. 351/2023 të datës 29.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokollit 4631/2023 të datës 08.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Tërheqje e ankesës e ankuesit me numër protokollit 4644/2023 e datës 09.06.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi _____ më datë 08.06.2023 me numër protokoll 4631/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër heshtjes administrative të Komunës së Fushë Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr. 351/2023 të datës 29.03.2023, mirëpo ankuesi më datë 09.06.2023 përmes tërheqjes së ankesës ka bërë tërheqjen e ankesës me numër protokoll 4631/2023 të datës 08.06.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me arsyetimin se është drejtuar gabimisht me ankesë. I njëjti potencon se kjo shkresë le të shërbejë si njoftim për moszbatim të vendimit të Këshillit me numër protokoll 3124/2023 të datës 29.03.2023 nga komuna e Fushë Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesi më datë 09.06.2023 përmes tërheqjes së ankesës ka bërë tërheqjen e ankesës me numër protokoll 4631/2023 të datës 08.06.2023, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.825/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

